



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 8.3.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE”

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 2.2.2022 dhe 8.3.2022, mori në shqyrtim projektligjin “Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Zj. Enslemvera Zake.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin present nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe përfaqësues të tjerë të kabinetit të saj si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji mbështetet në nenet 78 dhe 83 pika 1, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, arsyet e ndërmarrjes së iniciativës dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi

Projektligji “Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve”, ka për qëllim krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.

Objektivi kryesor i projektligjit është përcaktimi i rregullave bazë, procedurat si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarimin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe të ekosistemit mbështetës të tyre, në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu projektligji ka për objektiv mundësimin e zbatimit të mekanizmave mbështetës për krijimin e zhvillimin e startup-eve të reja, duke nxitur krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe duke synuar thithjen e aktorëve që mungojnë aktualisht, kryesisht të subjekteve që ofrojnë inkubim, mentorim e financim të startup-eve të reja.

Projektligji synon që përmes mbështetjes për zhvillimin e startup-eve të mundësohet gjithashtu, lehtësimi i krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së startup-eve, krijimi i një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe e burimeve njerëzore brenda vendit, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare si dhe përfshirjen sociale dhe diversiteti në mbrojtje të vlerave demokratike.

Projektligji padyshim, mundëson realizimin edhe të disa objektivave të tjera ambicioze, që në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë si më poshtë:

- përcaktimi i masave që mbështesin startup-et në fazën fillestare të biznesit dhe mbështetjen e ekosistemit për të krijuar një klimë të favorshme për to në vend;
- organet shtetërore, të cilat ngarkohen me detyrat e kompetencat për mbështetjen e startup-eve;
- përcaktimi i kriterëve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për certifikimin, mbështetjen, vlerësimin e monitorimin e startup-eve.

Projektligji parashikon disa forma të mbështetjes së Startup-eve që konsistojnë në mundësimin e shërbimit “Startup one-stop-shop”. Për këtë qëllim krijohet regjistri i startup-eve dhe lehtësuesve i cili do të administrohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen si bazë shtetërore të dhënash duke respektuar legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Një formë tjetër e parashikuar nga ligji për mbështetjen e Startup-eve, është edhe zhvillimi i ekosistemit mbështetës për startup-et, dhënia e granteve financiare ose masave mbështetëse për zhvillimin e startup-eve si dhe formave të tjera mbështetëse të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta.

Projektligji ka parashikuar organet përgjegjëse për realizimin e objektivave të tij, konkretisht ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, Këshillin e Startup-eve, komisionin e Vlerësimit si dhe ministritë ose institucionet e tjera publike.

Për këtë qëllim projektligji ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe konkrete detyrat e ministrit përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, ku do të evidentonim, zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e mbështetjes së startup-eve, koordinimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të startup-eve në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të sipërmarrjes në vend. I propozon Këshillit të Ministrave miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, miraton modelet tip të marrëveshjes së bashkëpunimit që nënshkruhen ndërmjet ministrisë, startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, miraton dhe publikon thirrjet për grante financiare ose masa mbështetëse, ku evidentohet forma dhe sasia e granteve financiare ose forma e masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta, miraton rregullat e procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrimit të startup-eve; asiston zhvillimin e ekosistemit mbështetës për startup-etj, vepron si organ mbështetës për startup-et, lehtësuesit dhe palët e treta duke bërë të mundur tërheqjen dhe duke mbështetur alokimin e fondeve ose të granteve të donatorëve të huaj për ekosistemin në Shqipëri etj.

Projektligji prashikon, ngritjen e funksionimit të Këshillit të Startup-eve, i cili jep kontribut në nxitjen e zhvillimit të startup-eve si organ kolegjal.

Filozofia që përpiqet të përcjelle projektligji është thjeshtësia, ne procedura dhe enë përfitimin e masave mbështetëse, për këtë qëllim projektligji parashikon që regjistrimi i një startup-i të bëhet përmes një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të startup-eve e lehtësuesve, duke u pajisur sipas rastit me dokumentin elektronik “pasaporta e startup-eve” ose “pasaporta e lehtësuesve”.

Regjistrimi dhe marrëdhënia e startup-eve dhe e lehtësuesve me ekosistemin dhe skemën e mbështetjes së startup-eve dhe lehtësuesve kryhet duke u bazuar në parimet “paperless” (pa letër) dhe “tarifa zero” në marrjen e shërbimeve.

Kohëzgjatja e periudhës së inkubimit dhe e statusit si “startup” është 24 muaj nga momenti i plotësimit të vetëdeklarimit në regjistrin e startup-eve.

Një risi tjetër e projektligjit është ofrimi i shërbimit “startup one-stop-shop”, përmes të cilit do të mundësohet:

- Dhënia e informacionit mbi kuadrin ligjor rregullator në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në informacionin mbi detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë, si dhe mbi detyrimin për regjistrim në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare si dhe mbi detyrimet fiskale dhe/ose detyrime të tjera që do t'ju nënshtrohen individët e vetëdeklaruar si startup pas periudhës së inkubimit;
- Dhënia e këshillimit lidhur me, regjistrimin në regjistrin tregtar dhe mbrojtjen e të drejtave civile dhe tregtare si dhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, pas periudhës së inkubimit;
- Organizimin e aktiviteteve informuese dhe njohëse ndërmjet startup-eve të interesuara; si dhe
- Dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të startup-eve., sipas përcaktimeve të miratuara me vendimi të Këshillit të Ministrave

Përzgjedhja e Startup-eve dhe lehtësuesve fitues do të bëhet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të projektligjit, si dhe do të mbështetet gjithashtu në prioritetet e përgjithshme, si: mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit; mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor; fuqizimi i grave sipërmarrëse; fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social; prioritetet e tjera, sipas urdhrit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Komisioni i Vlerësimit, i propozon ministrit përgjegjës për sipërmarrjen fituesit dhe ky i fundit më pas i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për miratimin e granteve të alokuara.

Projektligji nuk ka lënë jashtë vëmendjes edhe monitorimin e masave mbështetëse, ku ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, gjatë periudhës së inkubimit dhe periudhës së regjistrimit si startup ose si lehtësues i startup-eve, i monitoron periodikisht ato, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të këtij ligji.

Arsyet që diskantuan ndërmarrjen e kësaj iniciative

Referuar Raportit të Vlerësimit të Ndikimit (RIA) që bashkëshoqëron projektligjin, aktualisht, në Shqipërisë nuk ka mekanizma nxitës apo kuadër ligjor i cili rregullon specifikisht këto lloje biznesesh. Sektori i sipërmarrjeve të reja “startup” dhe programeve mbështetëse të tyre ka patur probleme të rëndësishme në lidhje me hyrjen në treg dhe përthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit në rritje kryesisht nga rinia shqiptare.

Megjithëse legjislacioni ekzistues “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” rregullon edhe disa çështje të cilat lidhen indirekt me Startup-et, si dhe ekzistojnë disa nisma mbështetëse të cilat prekin edhe Startup-et të tilla si fondet e zbatuara nga AIDA, fokusi i tyre është më i gjerë pasi këto fonde mbështesin çdo sipërmarrjeje të re, pra ky kuadër ligjor nuk është i adresuar specifikisht tek startup-etj. Sektori i startup-eve në Shqipëri ka pasur probleme për perthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit nga rinia shqiptare, dhe këto probleme reflektohen në aksesin dhe mbështetjen financiare të tyre.

Boshllëku ligjor në rregullimin e Startup-eve ka krijuar disa vështirësi të cilat konsistojnë:

- Konkretisht, mungon një përkufizimi ligjor mbi terminologjinë se çfarë konsiderohet një sipërmarrje e re në faze ideje ose produkti minimal të përdorshëm pra një “startup”;
- Ka vështirësi serioze, në lidhje me aksesin në financim, mungesa e mbështetjes ligjore për të marrë hua nga institucionet bankare, mungesa e garancive të rreziqeve të lidhura me kreditimin nga qeveria.
- Vështirësi tjetër përbën mungesa e informacionit mbi aspektet fiskale dhe ligjore që lidhen me krijimin e sipërmarrjeve të reja, sidomos nga të rinjtë si dhe mungesa e një kuadri ligjor që rregullon, nxit dhe përthith investimet e huaja dhe aktorët mbështetës në fushën e krijimit të sipërmarrjeve të reja që sjellin risi dhe stimulojnë ekonominë.
- Gjithashtu, si pjesë të vështirësive do të renditnim faktin se tregu lokal konsiderohet relativisht i vogël dhe ka vështirësi në hyrjen në tregun rajonal apo global.

Eksperiencia globale e tregjeve, vitet e fundit referon një rritje të shoqërive sipërmarrëse të cilat sjellin modele, produkte apo shërbime të reja të biznesit, të cilat kanë potencial rritje në shkallë botërore, duke sjellë në kohë të shkurtër, rritje ekonomike dhe punësim.

Aktualisht, disa prej të ashtuquajturave Startup-e, janë shndërruar në shoqëritë tregtare nga më të mëdhatë në botë dhe shumë prej tyre kanë sjellë modele të reja komunikimi, tregtie dhe biznesi.

Për gjithë sa mësipër evidentuam, duke konsideruar tendencat gjithmonë e më shumë në rritje drejt startup-eve dhe ekosistemeve të tilla në rajon dhe jo vetëm, lind nevoja e miratimit të një ligji të ri që adreson këto problematika.

IV. Konsultimi publik

Komisioni për Ekonominë dhe Financat nuk ka kryer konsultim publik lidhur me këtë projektligj, në formën e seancave dëgjimore, por anëtarë të Komisionit kanë ndërmarrë disa takime pune, me aktorë të ndryshëm që operojnë sot në treg si startup-ve, inkubatorë apo aceleratorë, me qëllim informimin me mënyrën e operimit sot të këtyre kompanive në treg,

me njohjen nga afër të mënyrës së funksionimit të tyre dhe me synimin për të vlerësuar me profesionalizëm projektligjin.

V. Zbatimi i projektligjit:

Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji është ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, si dhe ministritë e linjës ose institucionet e tjera publike brenda kompetencave të tyre.

VI. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

VII. Adresimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Projektligji bën një hap tjetër pozitiv në kuadër të plotësimittë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe konkretisht përkundrejt objektivit 5 I cili konsiston:

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Projektligji në nenit 14 të tij ka përcaktuar ndër të tjera që një ndër kushtet që duhen plotësuar për tu shpallur fitues për përfitimin e mbështetjes me grante për Startup-evt apo lehtësuesit e stratupeve të jetë fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse, duke bërë kështu një hap tjetër konkret në kuadër të fuqizimit të grave dhe vajzave.

VIII. Efektet Financiare

Projektligji mbart kosto financiare për Buxhetin e Shtetit, pasi parashikon ngritjen e regjistrimit dhe të portalit elektronik për startup-et. Sipas një vlerësimi paraprak, është parashikuar që kostoja ekonomike për ngritjen e këtyre dy sistemeve do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

Sipas RIA-as, duke përllogaritur shumën që do të alokohet nga buxheti i shtetit në formën e granteve dhe shërbime mbështetëse (trajnim, këshillim) vlerësohet se efekti të jetë në shumën 1.208.479.396 Lekë (10 milionë Euro), shumë kjo që mendohet të bëhet e disbursueshme përgjatë 4 vjecarit në vijim.

Për secilin nga këto 4 vite, është parashikuar gjithsej 302.119.849 lekë, ku përfshihen grante në formën e mbështetjeve financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si edhe pagesën për anëtarët e komisionit të përbërë nga 5 anëtarë ad-hoc, që do të mblidhet mesatarisht 3 herë në vit për përzgjedhjen e ideve fituese.

IX. Shqyrtimi i projektligjit në komision:

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes bëri një përshkrim të detajuar të projektligjit si dhe të arsyeve se përse është ndërmarrë kjo inisiativë. Ato theksuan ndër të tjera se projektligji ka për qëllim krijimin i një kuadri rregullator dhe institucional, i cili mbështet e favorizon krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë.

Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë:

- përcaktimi i lehtësirave fiskale, i programeve dhe masave që mbështesin startup-et në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubimit) dhe mbështetjen e ekosistemit për të krijuar një klimë të favorshme për to në Republikën e Shqipërisë;
- organet shtetërore, të cilat ngarkohen me detyrat e kompetencat për mbështetjen e startup-eve;
- përcaktimi i kriterëve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për certifikimin, mbështetjen, vlerësimin e monitorimin e startup-eve.

Relatorja e komisionit, gjithashtu bëri një prezantim të qëllimit, objektiva që kërkon të arrijë projektligji, qëllimin dhe objektin e tij si dhe evidentoi edhe disa nga risitë që sjell ky projektligj. Relatori argumentoi gjithashtu arsyet që diskutuan ndërmarrjen e kësaj iniciative ligjore.

Gjithashtu në përfundim të relatimit, relatorja evidentoi faktin se pavarësisht gjithë elementëve tejet pozitive që sjell ky projektligj, gjithashtu ka edhe disa elementëve të diskutueshëm që diktojnë nevojën për disa ndërhyrje dhe përmirësime nga komisioni.

Ajo theksoi se në cilësinë e saj si relatorë, por edhe deputetë të tjerë anëtarë të komisionit gjatë kohës në dispozicion për shqyrtimin e projektligjit, kanë ndërmarrë një sërë takimesh konsultuese me aktorë të ndryshëm në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, të tillë si biznese që aktualisht operojnë në treg si startup-eve, me lehtësues inkubatorë dhe akseleratorë, me ekspertë të ekonomisë, por edhe me Universitete.

Pas këtij procesi të gjatë konsultimi, i cili shërbu për njohjen më të mirë të konceptit të startup-eve, mënyrës së funksionimit të tyre, pas konsultimit me legjislacionin e shumë vendeve në Europë por dhe më gjerë, si dhe pas shqyrtimit tejet të vëmendshëm të

projektligjit të propozuar nga Këshilli i Ministrave, shihet e nevojshme ndërhyrja në projektligj në disa aspekte të rëndësishme ku do të veçonim.

Nevojën për saktësim dhe përmirësim të qëllimit dhe objektit të projektligjit dhe specifikisht nevojën për saktësime në përkufizimet e projektligjit, ndërhyrje këto janë tejet të rëndësishme për shkak se përkufizimi përcakton konceptet bazë të cilat gjejnë më pas trajtim në projektligj.

Kështu propozohen saktësime dhe riformulime në përkufizimin e konceptit të vetë startup-eve. Janë shtuar në gamën e lehtësuesve një kategori tejet e rëndësishme e tyre e cila mungonte, të tillë si subjektet që i ofrojnë Startup-eve financime alternative si investim kapitali, investim kapital risku (venture capital), skema voucher për inovacionin (innovation vouchers), engjëj biznesi (business angels). Është përmirësuar përkufizimii “nomadëve digjitalë” etj.

Saktësime janë bërë edhe në evidentimin apo përcaktimin e fushës së përgjegjësisë, funksionit dhe detyrave të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, kjo për vetë faktin se kompetencat apo strukturat e ministrit të shtetit janë disi të kufizuara dhe në këtë kontekst, është shmangur “përplasja e kompetencave dhe fushës së diskrecionit” mes ministrive të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore në kuadër të ligjit për menaxhimin financiar dhe buxhetor.

Saktësime janë bërë në projektligj edhe lidhur me përcaktimin e subjekteve përfitues nga mbështetja me grante, duke përfshirë tashmë në këtë kategori jo vetëm startup-et por edhe lehtësuesit, të cilët janë një pjesë tejet e rëndësishme e këtij procesi. Është saktësuar lloji i shërbimeve që do t’ju ofrohen këtyre subjekteve përmes shërbimit startup one stop shop.

Është saktësuar gjithashtu edhe dispozita mbi monitorimin e masave mbështetëse dhe kufizimin në maksimum të skemave abuzive me grantet e përfituara. Për këtë qëllim është shtuar përcaktimi që në rast të konstatimit të rasteve të abuzimit të masave mbështetëse nga startup-et, lehtësuesit ose palët e treta, ministri përgjegjës për sipërmarrjen mund t’i propozojë Këshillit të Ministrave kthimin e shumës së përfituar sipas këtij ligji.

Projektligji ka pësuar përmirësime të ndjeshme edhe në teknikë legjislative.

Anëtarët e komisionit adresuan një sërë pyetjesh lidhur me projektligjin ku do të evidentonim:

- Modelet legjislative që ekzistojnë sot në Europë dhe me gjerë lidhur me startup-et;
- Sqarimin e konceptit të periudhës së inkubimit, si dhe periudhën që konsiderohet si e tillë;
- Evidentimin e kompetencave të Ministrit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Mënyrën e funksionit të regjistrimit të startup-eve, shpalljes së thirrjes;

- Numrit të bizneseve të mundshme që do të mund të përfitojnë, nga skema mbështetëse me grante? Nëse skema e mbështetjes përmes granteve do të jetë skema e vetme apo nëse do të pasohet e plotësohet edhe me burime të tjera financimi;
- Buxheti i planifikuar që do të mund të vihet në dispozicion për këtë kategori etj.

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, bëri një shpjegim të detajuar të të gjitha pyetjeve të deputetëve, duke shpjeguar se si paraqitet legjislacioni në vende të ndryshme të botës, duke evidentuar edhe modelin më të mirë.

Ministrja sqaroi se, periudha e inkubimit do të jetë 24 muaj dhe do të fillojë nga momenti i vetëdeklarimit të biznesit si stratup në regjistrin e startup-eve.

Gjithashtu Ministrja theksoi se skema e granteve nuk është e vetmja skemë mbështetëse për këto biznese të reja, mbështetja do të jetë në disa aspekte dhe diapazone, duke filluar që nga momenti vetëdeklarimit të tyre, pra gjatë fazës së inkubimit ku përfshihet por pa u kufizuar, ofrimi i shërbimit one -stop- shop përmes të cilit këtyre bizneseve do tu jepet informacion lidhur me aspekte të ndryshme të funksionimit të biznesit si lidhur me çështjet e punës, detyrimet që duhet të paguajnë, detyrimet për regjistrim, mënyrës së funksionimit dhe organizimit të biznesit dhe të drejtave të tij, mënyrës së regjistrimit apo mbrojtjes së pronësisë intelektuale etj. Pjesë e mbështetjes do të jetë gjithashtu edhe mundësimi i skemave dhe burimeve të tjera të financimit përmes donatorëve.

Numri i bizneseve përfituese nuk është i mundur të përlogaritet me saktësi momentalisht, kjo do të varet nga numri subjekteve të vetëdeklaruar si stratup.

Komisioni gjatë shqyrtimit të nevojës për përmirësime të projektligjit shqyrtoi njëkohësisht edhe raportet dhe sugjerimet e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës dhe të Drejtave të Njeriut, të cilat e kanë shqyrtuar projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Më konkretisht:

Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka sugjeruar:

- Në nenin e përkufizimeve, në respekt të teknikës legjislative, termat të shqipërohen dhe me qëllim shmangien e keqkuptimeve në ndërlidhje me sistemin ndërkombëtar, në kllapa të shënohet termi anglisht.
- Duke konsideruar që ministri përgjegjës për sipërmarrjen, në një moment të mëvonshëm nuk do të jetë Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe me qëllim shmangien e ndërhyrjeve të panevojshme në ligj sa herë ndryshon ky emërtim, rekomandojmë që fjalët “Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” të zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për sipërmarrjen”

- Të drejtat dhe detyrimet e Startup-it gjatë periudhës së inkubimit duhet të jenë më të qarta, pasi nuk kuptohet qartë nëse trajtimi preferencial post-inkubim do të jetë i njëjtë me atë të periudhës së inkubimit apo jo.
- Të qartësohet roli i Këshillit të Startup-eve dhe funksionet kryesore të tij të përcaktohen në ligj, ndërkohë që elementë të tjerë të organizimit dhe funksionimit mund të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Nomadët digjitalë të parashikuar në këtë projektligj janë të përhapur në vend përtej asaj që është publikisht e dukshme ndaj referenca mbështetëse ndaj tyre duhet të jetë më e plotë, mund të ketë një dispozita të veçanta për ta ku të parashikohen edhe disa elementë të tjerë.
- Në lidhje me mbështetjen financiare të startup-eve, grantet janë padiskutim një element i vlerësuar dhe i nevojshëm, por i pamjaftueshëm. Në kushtet kur tregjet e kapitalit janë tërësisht të pazhvilluara dhe aksesit në financim është tejet i limituar, duhet parë më së paku që në projektligj të parashikohet mundësia e lehtësimit të financimit bankar duke subvencionuar interesin ose duke garantuar kolateralin të cilin një startup nuk e ka. Mungojnë burimet financiare alternative si kapital risku (*venture capital*), skema voucher për inovacionin (*innovation vouchers*), engjëj biznesi (*business angels*), etj, dhe projektligji duhet të ketë parashikime edhe për mënyra të tjera investimi.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat pas konsultimeve me përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, në cilësinë e komisionit përgjegjës konkludoi përfundimisht, në pranimin e sugjerimit bullit 2, lidhur me përdorimin në ligj të emërtesës si ministër përgjegjës për sipërmarrjen si dhe gjithashtu ka pranuar sugjerimin në bullit 6, për përfshirjen në grupin e lehtësuesve edhe të subjekteve që i ofrojnë Startup-eve financime alternative si investim kapitali, investim kapital risku (*venture capital*), skema voucher për inovacionin (*innovation vouchers*), engjëj biznesi (*business angels*).

Sugjerimet e tjera do të jenë objekt analizimi dhe detajimi i mëtejshëm përgjatë hartimit të akteve nënligjore të projektligjit.

Për sa i përket shqipërimit të termave me gjithë vullnetin e të gjitha palëve, u pa e pamundur, pasi janë terma që nuk ekzistojnë në një fjalë specifike në gjuhën shqipe.

Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës dhe të Drejtave të Njeriut ka sugjeruar:

- Në nenin 1 të projektligjit, fjala “krijimi” para togfjalëshit “kuadrit rregullator” të zëvendësohet me fjalën “hartimi”.
- Në nenin 3 të projektligjit, prapa çdo përkufizimi në pikat a, b, c, ç e d, të shtohen sipas kuptimit, fjala “është” ose “janë” .
 - Në shkronjën “ç” të nenit 3, togfjalëshi “puna e tyre kryesisht është puna lëvizëse” të zëvendësohet me togfjalëshin “punojnë kryesisht në distancë ose në lëvizje”;

- Tek shkronja “d” e nenit 3, për harmonizim me legjislacionin e zbatueshëm, para togfjalëshit “personi juridik ose fizik” të shtohet fjala “individ”.
- Tek Neni 7, në harmoni dhe me Nenin 6 togfjalëshi “ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” të zëvendësohet me togfjalëshin “ministri përgjegjës”

Këto sugjerime janë marrë në konsideratë dhe janë pasqyruar në ndryshimet e bëra nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

X. Përfundime

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi si dhe duke vlerësuar se miratimi i këtij projektligji do të mundësojë krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik, me votat pro të gjithë anëtarëve të komisionit të pranishëm në mbledhje e miratoi projektligjin, në parim, nen për nen dhe në tërësi me këto ndryshime:

- Në nenin 1, të projektligjit, fjala “krijimi” përpara fjalëve “kuadrit rregullator” zëvendësohet me fjalën “hartimi”, pas fjalës “ekosistemit” shtohen fjalët “të tyre” dhe pas fjalës “ideve” shtohen fjalët “inovative, si dhe”.
- Neni 2, i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 2 Objekti

Ky ligj përcakton rregullat bazë, procedurat si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarimin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe të ekosistemit mbështetës të tyre, në Republikën e Shqipërisë.”

- Në nenin 3 të projektligjit bëhen këto ndryshime:
 - Përpara çdo përkufizimi vendosen fjalët “është”, “janë”, “nënkupton”, në varësi të kontekstit të fjalisë;
 - Në shkronjën “a” termi “Ekosistem” zëvendësohet me termin “Ekosistem mbështetës për startup-et”;

- Në shkronjën “c”, pas fjalëve “organizatorë eventesh” shtohen fjalët “institucioneve të arsimit parauniversitar, shkollat e arsimit profesional” dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “si dhe subjekte që i ofrojnë Startup-eve financime alternative si investim kapitali, investim kapital risku (venture capital), skema voucher për inovacionin (innovation vouchers), engjëj biznesi (business angels).”

- Shkronja “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“ç) “Nomadët digjitalë”, janë shtetasit e huaj që punojnë në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të regjistruar dhe punojnë kryesisht në distancë ose në lëvizje, të cilët përfitojnë statusin e përfitimet e “punonjësit lëvizës digjital”, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;

- Shkronja “d” riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) “Startup”, janë individët dhe personat fizik ose juridik të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe vepronë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativdhe/ose teknologjik e të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.

- Neni 4, i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:

Neni 4

Objektivat e mbështetjes së startup-eve

Mbështetja për zhvillimin e startup-eve ka për synim:

- a) Lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimin e veprimtarisë së startup-eve;*
- b) Krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore;*
- c) Lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare;*
- ç) Përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike.*

- Në nenin 5 të projektligjit shkronja “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“ç) formave të tjera mbështetëse e lehtësuese të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta, sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Në nenin 6 të projektligjit dhe kudo në projektligj termi “*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*”, zëvendësohet me termin “*ministri përgjegjës për sipërmarrjen*”.

- Në nenin 7 të projektligjit bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pjesa hyrëse numërohet pika 1, dhe ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:”

- Në pikën e numërtuar 1, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Shkronja “c” riformulohet me këtë përmbajtje:

“c) Koordinon me ministrinë përgjegjëse për financat dhe ekonominë për planifikimin buxhetor të startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;”

- Shkronja “ç” riformulohet me këtë përmbajtje:

“ç) I propozon Këshillit të Ministrave, miratimin e fondeve buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta në përputhje me parashikimet e këtij ligji;”

- Në shkronjën “d”, pas fjalës “lehtësuesve” shtohen fjalët “dhe palëve të treta”.

- Shkronja “dh” riformulohet me këtë përmbajtje:

“dh) Miraton dhe publikon thirrjet për grante financiare ose masa mbështetëse, ku evidentohet forma dhe sasia e granteve financiare ose forma e masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e startup-eve, lehtësuesve dhe palëve të treta;”

- Shkronjat “f” dhe “g” riformulohen me këtë përmbajtje:

“f) Administron faqen zyrtare në internet të institucionit me qëllim informimin e ndërgjegjësimin e publikut, publikon thirrjet për grante si dhe ofron shërbimin “startup one-stop-shop” për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve;

g) Asiston zhvillimin e ekosistemit mbështetës për startup-et;

- Shkronja “gj” hiqet dhe ndryshon numeracioni i shkronjave në vijim.

- Në shkronjën “h”, të projekligjit fjala “*kërkesat*” zëvendësohet me fjalën “*aplikimet*”, pas fjalës “*startup-et*”, shtohen fjalët “*lehtësuesit dhe palët e treta*” dhe pas fjalës “*vlerësimit*” shtohet fjala “*të tyre*”;
 - Në shkronjën “i”, të projekligjit pas fjalës “*startup-et*”, shtohen fjalët “*lehtësuesit dhe palët e treta*”.
 - Në shkronjën “j”, të projekligjit pas fjalës “*startup-et*”, shtohen fjalët “*lehtësuesit dhe palët e treta*” dhe fjalët “*startup-et dhe inovacionin*” zëvendësohen me fjalën “*ekosistemin*”.
- Pas pikës 1 të numërtuar, shtohet një pikë 2 me këtë përmbajtje:

“2. Në ushtrimin e detyrave të tij sipas përcaktimeve të këtij ligji, ministri përgjegjës për sipërmarrjen, ndihmohet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, i cili ushtron veprimtarinë, bazuar në legjislacionin në fuqi për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar.”
- Në nenin 9 të projekligjit, bëhen këto ndryshime:
 - Në paragrafin e parë hyrës hiqen fjalët “*kanë përgjegjësitë dhe*”;
 - Në shkronjën “a” fjala “*marrjen*” zëvendësohen me fjalën “*ofrimin*”;
 - Në shkronjën “b”, fjalët “*idesë së biznesit*”, zëvendësohen me fjalën “*aplikimit*”, pas fjalës “*startup-it*” shtohen fjalët “*lehtësuesit ose palëve të treta*”;
 - Në shkronjën “c” fjalët “*në këtë ligj*” zëvendësohet me fjalët “*në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.*”
 - Në nenin 10 të projekligjit bëhen këto ndryshime:
 - Në pikën 1, në fillim të pikës përpara fjalës “*personi*”, shkrohet fjala “*Individi*”;
 - Në pikën 2 fjala “*plotësimit të*”, hiqet;
 - Në pikën 3, fjala “*regjistrimi*” zëvendësohet me fjalën “*vetëdeklarimi*” dhe pas fjalëve “*me ekosistemin*” shtohen fjalët “*mbështetës të tyre*”;
 - Në nenin 11, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1 fjalët “*krijohet e administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes*”, zëvendësohen me fjalët “*administrohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen*”;

- Pikat 2 dhe 3 riformulohen me këtë përmbajtje:

“2. Regjistri shërben për vetëdeklarimin e startup-eve dhe lehtësuesve për mbajtjen e të dhënave të startup-eve dhe të lehtësuesve të vetëdeklaruar, për kërkuesit dhe përfituesit e granteve dhe të masave të tjera mbështetëse.

3. Në momentin e vetëdeklarimit të startup-it, nga individi, personi fizik ose juridik, në regjistrin e startup-eve, automatikisht gjenerohet numri personal dhe dokumenti elektronik, pasaporta e startup-eve.”

- Në pikën 4, fjalët “*unik i identifikimit*”, zëvendësohen me fjalën “*personal*”.

- Në nenin 12 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 dhe 2 riformulohen me këtë përmbajtje:

“1. Me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe rritjes të startup-eve, ofrohet shërbimi startup one-stop-shop, pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

2. Shërbimi startup one-stop-shop mund të ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe në të përfshihen:

- a) Dhënia e informacionit mbi kuadrin ligjor rregullator në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në informacionin mbi detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës dhe sigurinë e shëndetit në punë, si dhe mbi detyrimin për regjistrim në regjistrin tregtar, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe mbi detyrimet fiskale dhe/ose detyrime të tjera që do t’ju nënshtrohen individët e vetëdeklaruar si startup pas periudhës së inkubimit;*
- b) dhënia e këshillimit lidhur me, regjistrimin në regjistrin tregtar dhe mbrojtjen e të drejtave civile dhe tregtare si dhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, pas periudhës së inkubimit;*
- c) organizimin e aktiviteteve informuese dhe njohëse ndërmjet startup-eve të interesuara;*
- ç) dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të startup-eve, sipas përcaktimeve të miratuara me vendimi të Këshillit të Ministrave.”*

- Në nenin 13 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet me këtë përmbajtje: “*Ministri përgjegjës për sipërmarrjen merr masa dhe angazhohet për të asistuar e bashkërenduar*

veprimtarinë e ekosistemit mbështetës për startup-et dhe asiston startup-et dhe lehtësuesit e përfshirë në ekosistem, në bashkëpunim me Këshillin.”

- Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Individit, personi fizik ose juridik, që ka fushë kryesore të veprimtarisë trajnimit ose dhënien e mbështetjes nëpërmjet formave të ndryshme në fushën e inovacionit dhe/ose teknologjisë ose në fusha të ngjashme me to, merr statusin e lehtësuesit të startup-eve, duke u vetëdeklaruar në regjistrin e startup-eve.”

- Neni 14 i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 14

Mbështetja e startup-eve dhe lehtësuesve të Startup-eve, nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse

- 1. Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve të vetëdeklaruar në regjistrin mund të përfitojnë mbështetje financiare me fonde buxhetore në formën e granteve, si dhe nga burime të tjera financimi, përfshirë por pa u kufizuar në donacionet e huaja dhe/ose nga investimet e lehtësuesve, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, nëse plotësojnë kriteret dhe rezultojnë fitues pas një procesi konkurrues e transparent përzgjedhjeje.*
- 2. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall thirrjen për aplikime nga ana e startup-eve dhe lehtësuesve të e startup-eve, nëpërmjet publikimit në shërbimin startup one stop-shop, në faqen zyrtare.*
- 3. Thirrja për aplikime për përfitimin e granteve dhe të masave mbështetëse përmban kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, procedurat dhe afatet respektive, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh prioritetet e përgjithshme, si më poshtë vijon:*
 - a) Mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;*
 - b) Mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;*
 - c) Fuqizimi i të rinjve;*
 - ç) Fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse*
 - d) Fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;*
 - dh) Prioritete të tjera, sipas urdhrimit të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.*
- 4. Me qëllim vlerësimit të kërkesave nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve ngrihet Komisioni i vlerësimit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen. Rregulla të hollësishme për përbërjen e Komisionit të vlerësimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

5. *Startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve aplikues shpallen fituese me vendim të komisionit të vlerësimit vetëm nëse plotësojnë kriteret dhe përcaktimet e pikës 3, të këtij neni.*
 6. *Vendimi i komisionit të vlerësimit për përfituesit e granteve financiare për mbështetjen e startup-eve, sipas thirrjes, botohet në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.*
 7. *Ministri përgjegjës për sipërmarrjen i propozon Këshillit të Ministrave vendimin për miratimin e dhënies së grantit nëpërmjet njësisë përgjegjëse. Vendimi i Këshillit të Ministrave zbatohet nga njësia përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për buxhetin e shtetit.”*
- Në nenin 15 të projektligjit bëhen këto ndryshime:

- Pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Ministri përgjegjës për sipërmarrjen, gjatë periudhës së inkubimit dhe deri në përfundimin e zbatimit të projektit të mbështetur financiarisht si startup ose si lehtësues i startup-eve, monitoron periodikisht startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve, që kanë fituar masë mbështetëse nëpërmjet granteve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të këtij ligji.”

- Në pikën 2, fjalët *“dhe struktura përgjegjëse e tij”* hiqen.
- Në pikën 3, fjalët *“në urdhrin përkatës të”* bëhen *“me urdhër të”*.
- Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast të abuzimit të masave mbështetëse nga startup-et, lehtësuesit ose palët e treta, ministri përgjegjës për sipërmarrjen mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave kthimin e shumës së përfituar sipas këtij ligji.”

- Neni 16, saktësohet duke u riformuluar si më poshtë:

Neni 16

Aktet nënligjore

1. *Ngarkohen Këshilli i Ministrave që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 5; 8 pika 4; 9 shkronjat “a”; 11 pika 5; 12 pika 3; 13 pikat 1 dhe 3 dhe 14, pikat 3 dhe 7 të këtij ligji.*

2. *Ngarkohet ministri përgjegjës për sipërmarrjen, që brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim, të nenit 15 pika 3, të këtij ligji.”*

RELATOR

KRYETAR

Enslemvera ZAKE

Eduard SHALSI